



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 103, datë 25.03.2022

**PËR
VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN PËRFUNDIMTAR TË KANDIDATIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.03.2022, në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 172, datë 11.09.2019, pas përfundimit të intervistës me kandidatin z. {...}, bazuar në të dhënat që rezultuan nga intervista, sikundër edhe nga të dhënat e rezultuara nga dokumentet e paraqitura nga kandidati dhe ato të administruara gjatë procedurës së përzgjedhjes, mbasi shqyrtoi projekt vendimin “Për vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit z. {...}” përgatitur nga relatori i çështjes,

VËREN

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, sipas shkronjës “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në *fushën e të drejtës civile*.
3. Por pozicionin e lirë të shpallur si më lart, brenda afatit të përcaktuar, ka aplikuar edhe kandidati z. {...}.
4. Për kandidatin z. {...}, sikundër edhe për kandidatët e tjerë, fillimisht Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit dhe, në përfundim, me vendimin nr. 560, datë 13.11.2020, ka vendosur: *“Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*.
5. Ndërkohë, me Vendimin nr. 262, datë 13.11.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, ka vendosur:

“1.Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2.Caktimin e z. Dritan Hallunaj si relator për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”

6. Në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Vendimit të tij nr. 102, datë 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 102/2019), si dhe të Vendimit të tij nr. 209, datë 11.10.2019 “Për miratimin e “Metodologjisë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë” (më poshtë referuar si Metodologjia e Vlerësimit dhe Pikëzimit), Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 102, datë 25.03.2022, miratoi vlerësimin dhe pikëzimin paraprak për kandidatin z. {...}. Sipas këtij vendimi, kandidati është vlerësuar dhe pikëzuar paraprakisht me 85 pikë në total.

7. Në vijim të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, pas vlerësimit dhe pikëzimit paraprak, në zbatim të pikës 7, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, sikundër dhe Vendimit të tij 102/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi me kandidatin z. {...} një intervistë, në një seancë publike, më datë 25.03.2022.

8. Gjatë intervistës, kandidati u pyet nga Këshilli, duke marrë nga ai përgjigjet në lidhje me: motivet dhe arsyet që e kanë shtyrë për të kandiduar për në Gjykatën e Lartë, duke specifikuar dhe objektivat që kishte nëse emërohej gjyqtar i kësaj gjykate; elementët e formimit dhe të eksperiencës së tij që, sipas opinionit të tij, e kishin përgatitur për të adresuar çdo aspekt në lidhje me juridiksionin e Gjykatës së Lartë, problematika kryesore aktualisht në Gjykatën e Lartë dhe strategjia e tij për kapërcimin e saj; dhe dilemën etike më sfiduese që kishte pasur gjatë karrierës si Komisioner Publik dhe mënyrën si e kishte zgjidhur atë. Gjithashtu ai u pyet lidhur me rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në funksionalitetin e Gjykatës së Lartë, në përgjigje të së cilës, ndër të tjera theksoi rëndësinë e njësisë së shërbimit ligjor, dhe pajisjen e secilit gjyqtar me këshilltarë ligjorë.

9. Pas intervistës me kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vijoi shqyrtimin dhe vendosi në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit për secilën kategori, kriter, nënkriter dhe tregues, të përcaktuar në pikën 6, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të detajuara më tej në Vendimin e tij 102/2019, ku përcaktohen në detaje ndarja e kategorive të vlerësimit në kritere, nënkritere dhe treguesit vlerësues për pikëzimin, pikëzimi maksimal për secilin nga ato, burimet dokumentare dhe disa të dhëna për metodologjinë në funksion të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Pikëzimit, ku shpjegohen orientimet që mban parasysh Këshilli në vlerësimin dhe caktimin e pikëve për secilën kategori të meritave të kandidatit, kriter, nënkriter apo tregues të tyre.

10. Sipas akteve normative të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë vlerësohet dhe pikëzohet për tre kategori vlerësimi, të cilat me tej detajohen në kritere, nënkritere apo tregues/indikator, ku secila nga këto vlerësohet dhe pikëzohet.

11. Kategoria e parë e vlerësimit është “Meritat profesionale”. Kjo kategori vlerësimi ndahet në tre kritere, të cilët nga ana tjetër ndahen në nënkritere dhe një prej tyre edhe në tregues.

12. Kriteri i parë i Kategorisë “Meritat profesionale”, është “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”. Ky kriter vlerësimi ndahet në pesë nënkritere, e më konkretisht:

- a) “Historiku arsimor” ose “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi”;
- b) “Rezultatet e programeve të formimit fillestar”;
- c) “Rezultatet e përvojës në profesion”;
- ç) “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”
- d) “Aftësitë gjuhësore.

13. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Historiku arsimor” ose “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi”:

13.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c”, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi i Këshillit 102/2019 i dalë në zbatim të ligjit, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe “rezultatet e studimeve të larta për drejtësi”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, nënkriteri “Historiku arsimor” apo “Rezultatet e studimeve të larta për drejtësi” vlerësohet dhe pikëzohet deri në 2 pikë, duke iu referuar mesatares së notave jo më pak se 8, ose të barasvlershme me të, nëse studimet janë përfunduar jashtë vendit. Për vlerësimin e kandidatëve caktohet 1 pikë, duke filluar nga mesatarja e notave 8.

13.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka ndjekur studimet universitare dhe për këtë u administruan:

- Diplomë nr. {...}, datë 03.02.2004, lëshuar nga Universiteti i Athinës, Greqi, sipas të cilit kandidati {...} i është dhënë titulli “Jurist”. Po ashtu, kandidati ka depozituar një Dokument Nr. Regjistri {...}, Datë 22.02.2005, të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Njohjes së Diplomave, sipas të cilit: *“Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.523, datë 01.08.2003 “Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe të certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja”, Komisioni i ngritur me Urdhërin nr.388, datë 15.12.2004 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në mbledhjen e datës 11.02.2005, mbasi ka shqyrtuar dokumentet e z.{...}, vendosi “Njohjen e kopjes së diplomës me Nr. {...} Prot., datë 03.02.2004 me titullin “Jurist”, lëshuar nga Universiteti i Athinës, Greqi”.*

13.3 Sipas dokumenteve të administruara, kandidati z. {...} ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti National Kapodistrian of Athens dhe është diplomuar “jurist” në dhjetor të vitit 2003, duke dhënë betimin në datën 3.02.2004. Ndërkohë, sipas listës së rezultateve të provimeve, lëshuara nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti National Kapodistrian of Athens, sikundër edhe nga vetëdeklarimi i kandidatit në jetëshkrimin e tij, rezulton

se mesatarja e studimeve të tij universitare 4-vjeçare është 8,2. Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, arsimi i kandidatit kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

13.4 Ndaj nga sa rezultoi, për nënkriterin e vlerësimit “Historiku arsimor” apo Rezultatet e studimeve të larta për drejtësi”, duke patur parasysh notën mesatare të studimeve në drejtësi të kandidatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 1 pikë.

14. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Rezultatet e programeve të formimit fillestar”:

14.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Vendimi 102/2019, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe “*rezultatet e programit fillestar*”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, në programet e formimit profesional përfshihen Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë, Shkolla e Administratës Publike, etj., të cilat kontribuojnë në rritjen e profesionalizmit. Me anë të këtij nënkriteri vlerësohet niveli i rezultateve të angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit fillestar profesional që mundësojnë arritjen e një profesionalizmi më të lartë në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave profesionale. Për këtë nënkriter Këshilli cakton 1 pikë për rezultatet e studimeve të vlerësuara një nivel më të ulët se niveli maksimal (“*mirë*” ose “*shumë mirë*”, sipas programit) dhe 2 pikë për rezultate të vlerësuara në nivelin maksimal (“*shumë mirë*” ose “*shkëlqyeshëm*”, sipas programit).

14.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati {...} nuk rezultoi të ketë ndjekur programe të formimit fillestar të tilla si Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë, Shkolla e Administratës Publike etj.

14.3 Ndaj nga sa rezultoi, për nënkriterin e vlerësimit “Rezultatet e programit fillestar”, duke patur parasysh se kandidati nuk ka ndjekur programe të formimit fillestar, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 0 pikë.

15. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Rezultatet e përvojës në profesion”:

15.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe “*rezultatet e përvojës në profesion*”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, me anë të këtij nënkriteri vlerëzohet niveli i rezultateve të arritura gjatë përvojës së kandidatit në profesionin e juristit. Duke marrë parasysh të dhënat dhe informacionet në dispozicion, Këshilli cakton 2 pikë për rezultatet e arritura gjatë përvojës profesionale si jurist të vlerësuara një nivel më të ulët se niveli maksimal (“*mirë*” ose “*shumë mirë*”, sipas llojit të profilit) dhe 4 pikë për rezultatet e vlerësuara në nivelin maksimal (“*shumë mirë*” ose “*shkëlqyeshëm*”, sipas llojit të profilit). Për kandidatët për të cilët nuk ka vlerësime nga sisteme zyrtare vlerësimi, do të merren për bazë opinionet vlerësuese të strukturave drejtuese të organizmave ku ata bëjnë pjesë (*si për shembull departamenti ose dekanati, dhoma e avokatisë, dhoma e noterëve, dhoma e ndërmjetësuesve etj.*).

15.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka përvojë të gjatë si jurist, ndërsa për rezultatet e përvojës në profesion u

administruan disa opinione vlerësuese të strukturave drejtuese të organizmave ku ai ka bërë pjesë, e më konkretisht:

- a) Vlerësimin e Rektorit të “Universiteti European i Tiranës”, Prof. Dr. {...}, që mban datën 09.12.2020 rezultoi se: “... Prof. Asoc. Dr. {...} është njohur personalisht nga ana ime gjatë punësimit të tij si staf I brendshëm në Universitetin European të Tiranës, në vitet akademike 2009-2013. Ai ka qënë lektor në lëndët ‘E drejtë Publike’ dhe ‘Shkrim dhe Arsyetim Ligjor’ në nivelin Bachelor dhe titular I lëndës Metoda Kërkimi I në Drejtën Publike dhe Civile, në ciklin e dytë të studimeve, Master I Shkencave. Gjithashtu z. {...} ka qënë titular I kësaj lënde në ciklin e tretë të studimeve të doktoratës. Gjatë punësimit të tij në UET, z. {...} ka qënë udhëheqës shkencor i punimeve të doktoratës së studentëve të këtij institucioni. Gjatë kësaj periudhe, z. {...} është shquar në mënyrë të qartë si një figurë profesionale e një niveli shumë të lartë. Ai është vlerësuar maksimalisht nga studentët e tij dhe është cilësuar si një prej pedagogëve më të përgatitur e të aftë të Universitetit European të Tiranës. Performancën akademike të z. {...} e kam vlerësuar si shumë të kënaqshme. Ai është gjithashtu me aftësi të larta intelektuale dhe analitike. Si pjesë e stafit akademik, ai është shfaqur me kapacitet të lartë për të punuar në mënyrë efektive Brenda punës në grup dhe për të ndarë me të tjerët idetë e tij. Z. {...} ka treguar që ka besim në vetvete, është i pjekur, miqësor dhe person stabël emocionalisht. Ai ka treguar se disponon aftësi të veçanta analitike, për të kryer në mënyrë efektive të gjitha detyrimet e tij në fushën akademike dhe profesionale. Z. {...} është vetëmotivuar dhe jam I bindur se ai ka aftësinë për të përballuar me sukses çdo lloj detyre që kërkohet prej tij. Jam I gëzuar që z. {...} kandidon si anëtar I Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, pasi besoj që ai disponon të gjitha aftësitë akademike dhe profesionale, për të ndihmuar këtë institucion të rëndësishëm të ecë përpara.’
- b) Vlerësimin e ish-Rektorit të “Universiteti Luarasi”, Prof. Dr. {...}, që mban datën 07.12.2020 rezultoi se: “Performanca e tij gjatë gjithë vitit akademik 2014-2015 ka qënë e një niveli maksimal. Z. {...} është një individ me potenciale të mëdha si dhe një njeri profesionist. Ai ka treguar një devotshmëri të lartë dhe ka pasur një sjellje shumë korrekte me kolegët e Universitetit gjatë ushtrimit të detyrave akademike. Ai disponon aftësi shpirtërore, ka shpirt kritik si dhe karakterizohet nga një nivel I lartë integriteti. Përpikmëria në ndjekjen e procedurave akademike, ligjore, përpilimi dhe hartimi I rregulloreve dhe kurikulave të Universitetit, programeve të reja studimore për akreditim pranë Ministrisë së Arsimit krijuan tek mua bindjen se z. {...} I përmbush me efikasitet dhe korrektësi të gjitha detyrat e ngarkuara. Z. {...} është I pjekur, miqësor dhe person stabël emocionalisht. Ai ka treguar se disponon aftësi të veçanta analitike për të kryer në mënyrë efektive të gjitha detyrat e ngarkuara në fushën profesionale. Z. {...} është I vetë-motivuar dhe ka treguar që është produktiv dhe kur është në presion të vazhdueshëm. Menidmi I tij I thellë juridik dhe inteligjenca e treguar prej z. {...} kanë bërë të mundur zgjidhjen e shumë çështjeve që kishin të bënin me ushtrimin sa më të mirë të detyrave akademike të Universitetit Luarasi. Për të gjitha arsyet e mësipërme jam I lumtur që z. {...} është një kandidat për anëtar I Gjykatës së Lartë të Shqipërisë. Kandidatura e tij mendoj se përbën një vlerë për këtë institucion të rëndësishëm të vendit tonë.’
- c) Vlerësimin e Dekanit të “Canadian University”, Prof. Assoc. Artur Jaupaj, që mban datën 07.12.2020 rezultoi se “... Z. {...} është diplomuar në vitin 2003, pranë Fakultetit të

Drejtësisë të Universitetit Kombëtar të Athinës dhe që nga viti akademik {...} ka qënë I angazhuar si professor I jashtëm pranë Canadian University në lëndët Business Laë dhe Financial Market Laë. Ai është dalluar për këmbënguljen dhe apiratat e larta, për aftësitë e tij të qarta në fushën e së drejtës civile, prirjen për të qënë konsekuent në veprimet e tij dhe korrekt me detyrat e ngarkuara. Këto cilësi janë zhvilluar më tej, falë eksperiencës së fituar si Komisioner Publik pranë organeve të vetingut të Republikës së Shqipërisë. Mendoj se, përgatitja e deritanishme e z. {...}, serioziteti, aftësitë e tij për t'u marrë me çështje ligjore të çdo natyre, aftësitë për të koordinuar dhe projektuar punën, aftësitë shumë të mira planifikuese dhe organizative, do t'i konsideroja si merita të qënësishe të vullnetit dhe karakterit të tij individual. Gjatë këtyre viteve akademike z. {...} është vlerësuar maksimalisht nga studentët e Universitetit tonë, vlerësime që gjenden në dosjen e kandidimit të tij për këtë pozicion. Performanca në mësimdhënie dhe përgatitja e tij akademike është vënë re nga të gjithë në stafi drejtues I Canadian University. Kandidimi I tij për anëtar i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë mendoj se ndihmon rritjen profesionale të institucioneve shqiptare. Niveli I lartë akademik që zotëron z. {...} është vërtetuar dhe nga vendet e BE, fakt që tregon aftësitë e larta profesionale dhe mendore që disponon ky kandidat për pozicionin e lartë që ai aspiron.'

- ç) Vlerësimin e ish-Rektorit të "Universitetit të Nju Jorkut", Prof. {...}, që mban datën 07.12.2020 rezultoi se: "Z. {...} ka qënë Profesor i Asociuar me kohë të plotë gjatë viteve akademike 2015-2018 në lëndët 'E Drejtë Tregtare', 'E Drejtë Civile' dhe 'E Drejtë Detyrimesh'. Në cilësinë e lektorit z. {...} ka qënë një ndër më të dalluarit në Universitetin e Neë Yorkut. Përpos kësaj unë kam vlerësuar veçanërisht tek ai rigorozitetin dhe ndjenjën e përgjegjësisë në kryerjen e detyrës, si dhe bashkëpunimin e tij të ngushtë me dekanin e fakultetit përkatës dhe me Rektoratin e universitetit. Z {...} është dalluar për profesionalizmin, integritetin dhe vullnetin pozitiv në mbarëvajtjen e procesit pedagogjik, si dhe për marrëdhënie kolegjiale shumë të mira me stafin akademik dhe me punonjësit e administratës së atij institucioni. Kontributi i z. {...} në mbarëvajtjen dhe në sukseset e njohura të atij institucioni akademik janë evidentuar vazhdimisht nga Rektorati I Universitetit të Tiranës. Nga pozicioni im si Rektori I Universitetit, bashkëpunimi me z. {...} ka qënë jo thjesht I kënaqshëm, por mjaft I dobishëm, pasi unë kam çmuar tek ai njohuritë e tij profesionale, aftësitë pedagogjike si dhe shumë cilësi të tjera të karakterit e të humanizmit të tij. Z. {...} ka qënë një punonjës akademik i respektuar dhe i dashur nga kolegët dhe studentët e tij. Vlerësim maksimal për z. {...} kanë dhënë nëpërmjet pyetësorëve periodikë edhe studentët e këtij Universiteti, të cilat besoj se ju dispononi në dosjen e kandidimit të tij. Z. {...} ka drejtuar në mënyrë korrekte dhe efikase Departamentin e Drejtësisë në Universitetin e Neë Yorkut në Tiranë duke përpiluar dhe hartuar saktë dhe në një kohë të shpejtë raportet e transferimit të studentëve. Gjithashtu ka marrë pjesë në grupet për hartimin e Raporteve të vlerësimit të brëndshëm për disa programe studimi, duke kontribuar me qasjen e tij positive ndaj punës në grup, si dhe në realizimin e akreditimit të programeve të studimit në nivelet Bachelor, Master dhe doctoral. Unë e vlerësoj maksimalisht figurën dhe kandidaturën e z. {...} në pozicionin e anëtarit të Gjykatës së Lartë pasi besoj se vlerat e tij akademike e profesionale do i shërbejnë këtij institucioni të rëndësishëm të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

15.3 Sipas dokumenteve të administruara, opinioneve vlerësuese të drejtuesve të institucioneve, subjekteve si më lart, ku kandidati ka marrë pjesë, rezultoi se kandidati karakterizohet nga

angazhimi dhe serioziteti, përkushtimi dhe ndjenja e përgjegjësisë në punën që merr përsipër dhe kryerjen e detyrës, duke shfaqur korrektesë, të cilat janë shoqëruar me sjellje etike e morale të lartë. Kandidati dallohet për këmbënguljen dhe apiratat e larta, për aftësitë e tij të qarta në fushën e së drejtës civile, prirjen për të qënë konsekuent në veprimet e tij dhe korrekt me detyrat e ngarkuara. Këto cilësi, kandidati i ka zhvilluar më tej, falë eksperiencës së fituar si Komisioner Publik pranë organeve të vetingut të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, përgatitja e deritanishme e kandidatit, serioziteti, aftësia e tij për t'u marrë me çështje ligjore të çdo natyre, aftësia për të koordinuar dhe projektuar punën, aftësitë shumë të mira planifikuese dhe organizative, mund të konsiderohen si merita të qënësishme të vullnetit dhe karakterit të tij individual.

15.4 Ndaj nga sa rezultoi, për nënkriterin e vlerësimit “Rezultatet e përvojës në profesion”, pasur parasysh përfundimet e arritura nga dokumentacioni i administruar, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 4 pikë.

16. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”:

16.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c” i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/209, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe “rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit ky nënkriter është zbërthyer në tre tregues, e konkretisht:

- i) “Rezultatet e trajnimeve të tjera”;
- ii) “Rezultate e kualifikimeve pasuniversitare”;
- iii) “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë”.

16.2 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, për vlerësimin dhe pikëzimin e këtij nënkriteri, Këshilli vlerëson: i) “Rezultatet e trajnimeve të tjera” - deri në 2 pikë; ii) “Kualifikimet pasuniversitare” - deri në 3 pikë [2 pikë për studime, me rezultate të larta (1 pikë për mesatare 8-9; 2 pikë për mesatare 9.1-10) të kryera në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë (1.5 pikë për mesatare 8-9; 3 pikë për mesatare 9.1-10) nëse studimet janë kryer në vendet e BE/OECD]; si dhe iii) “Gradat shkencore dhe titujt akademikë” - deri në 4 pikë [për rezultatet e larta, 95-100 pikë, ose ekuivalente, gjatë studimeve të doktoraturës në drejtësi, Këshilli cakton deri në 2 pikë nëse grada shkencore “Doktor” është kryer në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë nëse grada shkencore është kryer në vendet e BE/OECD; për titullin akademik “Profesor i asociuar”, duke marrë parasysh fushën dhe institucionet e punësimit, Këshilli cakton deri në 2 pikë nëse kandidati e ka fituar titullin akademik në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë nëse kandidati e ka fituar atë në vendet e BE/OECD; për titullin akademik “Profesor ose Professor Emeritus”, duke marrë parasysh fushën dhe institucionet e punësimit, Këshilli cakton deri në 3 pikë nëse kandidati e ka fituar titullin akademik në Shqipëri, dhe deri në 4 pikë nëse kandidati e ka fituar atë në vendet e BE/OECD]. Në çdo rast, totali i pikëve të caktuara nuk mund të jetë më i lartë se maksimumi i pikëve për këtë kriter - 8 pikë. Për të realizuar një vlerësim sa më objektiv të kandidatëve që kanë tituj akademikë, grada shkencore, apo që kanë kryer studime të tjera afatgjata, mastera ekzekutivë dhe trajnime të tjera, mbahen në konsideratë edhe kriteret e përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë (Ligjin nr. 80/2015). Në lidhje me trajnimet e realizuara referuar Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit,

trajnimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, për efekt vlerësimi, duhet që të jenë të 10 (dhjetë) viteve të fundit.

16.3 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka kryer studime pasuniversitare, ka gradë shkencore në drejtësi dhe ka titullin "profesor i asociuar".

16.4 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin "Trajnime të tjera":

16.4.1 Për treguesin "Trajnime të tjera", referuar jetëshkrimit, rezultoi se kandidati ka marrë pjesë në një sërë konferencash shkencore dhe në disa trajnime në cilësinë e lektorit por në 10 vitet e fundit rezulton të ketë marrë pjesë në trajnimin e zhvilluar në Shtator 2017- Shtator 2020, në kuadrin e Programit "Erasmus + Programme-Jean Monnet Activities", me tematike "E drejta e Refugjatit", nga Universiteti i Neë Yorkut Tiranë.

16.4.2 Sipas dokumentacionit të administruar, Referuar këtij treguesi dhe metodologjisë së pikëzimit, vlerësohen rezultate e trajnimeve si dhe numri i tyre. Pjesëmarrja në vetëm 1 trajnim nuk mund të justifikojë pikëzimin e kandidatit për kete tregues.

16.4.3 Ndaj nga sa rezultoi, për treguesin e vlerësimit "Rezultatet e trajnimeve të tjera", Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 0 pikë.

16.5 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin "Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare":

16.5.1 Për treguesin e vlerësimit "Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare", referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka kryer kualifikim pasuniversitar në vitin 2004-2005, ku ka ndjekur kualifikim pasuniversitar "Master of Arts", në Universitetin Kombëtar të Athinës, me notë mesatare 8.4 e ponderuar sipas kriterëve të Shkollës së Magjistraturës. Në mbledhjen e datës 11.02.2009, me nr. Regjistri {...}, Komisioni i Njohjes ka vendosur: Njohja e Diplomës së Studimeve Pasuniversitare të z. {...} Skënder {...} nga Universiteti Kombëtar e Kapodistrian i Athinës, Greqi, me program 1-vjecar në Studime të Europës Juglindore, si Diplomë e Nivelit të Dytë.

16.5.2 Ndaj nga sa rezultoi, për treguesin e vlerësimit "Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare", duke patur parasysh notën mesatare të kualifikimit pasuniversitar, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 1.5 pikë.

16.6 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin "Gradat shkencore dhe titujt akademikë":

16.6.1 Për treguesin e vlerësimit "Gradat shkencore dhe titujt akademikë", referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka gradë shkencore në drejtësi, nga ku rezulton se ai në vitet 2005-2011, ka ndjekur studimet në Universitetin Kombëtar të Athinës, duke marrë gradën shkencore "Doktor", nëpërmjet paraqitjes së disertacionit me temë "E drejta e Asociimit" dhe është vlerësuar "Shkëlqyeshëm". Me vërtetimin nr. {...} prot., datë 30.04.2013 të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademik përcaktohet se grada e lartpërmendur, e fituar në Greqi nga z. {...} Skënder {...} është e barazvlefshme me gradën shkencore "Doktor" në Republikën e Shqipërisë. Grada e z. {...}

Skënder {...} është e regjistruar ne regjistrin për gradat shkencore dhe titujt akademikë të mbrojtur jashtë vendit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, në datën 29.04.2013 dhe ka numrin rendor 157. Gjithashtu rezultoi se me Dëshminë nr. {...}, me nr. Regjistri të KVTA {...}, lëshuar me datë 15.01.2016 nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, kandidati {...} {...} ka fituar titullin “Profesor i Asociuar”.

16.6.2 Ndaj nga sa rezultoi, për treguesin e vlerësimit “Gradat shkencore dhe titujt akademikë”, duke patur parasysh rezultatin e gradës shkencore në drejtësi të kandidatit dhe faktin që grada shkencore është marrë në një shtet të OECD/BE dhe titulli “profesor i asociuar” është marrë në Shqipëri, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se ai duhet të vlerësohet me 4 pikë.

16.7 Për rrjedhojë, për nënkriterin “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 6 pikë në total.

17. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Aftësitë gjuhësore”:

17.1 Neni 49, pika 6, shkronja “ç”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019 dalë në zbatim të ligjit, përcaktojnë si nënkriter për të vlerësuar aftësitë profesionale të kandidatëve edhe *“aftësitë gjuhësore”*. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” vlerësohet dhe pikëzohet deri në 4 pikë, duke mbajtur parasysh njohjen nga kandidatët të pesë gjuhëve të huaja anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Për këtë, Këshilli vlerëson dhe pikëzon me përparësi njohuritë në gjuhët angleze dhe franceze, ku në varësi të shkallës së zotërimit, kandidati vlerësohet deri në 1,5 pikë për secilën gjuhë. Po ashtu, Këshilli vlerëson dhe pikëzon edhe njohuritë në gjuhët e tjera të deklaruara nga kandidati, për të cilat nuk testohet me kushtin që të jenë të shoqëruara me dokumente vlerësuese të vlefshme për nivelin e njohurive të tyre. Për gjuhët e tjera, të ndryshme nga anglishtja dhe frëngjishtja, kandidati kandidatit i shtohet deri një 1 pikë. Po sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi i kandidatit për shkallën e zotërimit të gjuhës së huaj bazohet në: *testet ndërkombëtare, sipas Ligjit nr. 80/2015 dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr. 52, datë 03.12.2015; osemendimin me shkrim të dhënë nga ekspertët, të cilët, pas intervistës që zhvillohet me kandidatin për këtë qëllim, japin vlerësimin e tyre për nivelin njohjes së gjuhës së huaj.*

17.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi që kandidati {...} zotëron katër gjuhë të huaja, “Anglisht”, ‘Greqisht’ “Italisht” dhe “Gjermanisht”. dhe për këtë u administruan:

- Studimet Master dhe Doktoraturën e zhvilluar në gjuhën angleze.
- Vërtetimi i gjuhës greke lëshuar nga Universiteti i Filozofisë në Greqi në vitin 1998, si dhe Diploma zyrtare e lëshuar nga Univesiteti Kombëtar i Athinës, nr. {...}, datë 03.02.2004.
- Dëshmi e zotërimit të gjuhës italiane e lëshuar nga Univesiteti i Tiranës/Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, datë 16.11.2019, ku rezultoi se është vlerësuar me notën 9 (nëntë);

- Dëshmi e zotërimit të gjuhës gjermane (niveli B2-C2) e lëshuar nga Universiteti ETH I Zyrihut, më datë 22.05.2014 (dhe ajo e nivelit B2-C1) e lëshuar nga Universiteti ETH I Zyrihut, më datë 27.05.2014.

17.3 Sa i përket shkallës së zotërimit nga kandidati të katër gjuhëve të huaja si më lart, një gjë e tillë rezultoi sipas alternativës së parë të vlerësimit, pra bazuar në testet ndërkombëtare (për tre nga gjuhët e mbrojtura), sipas Ligjit nr. 80/2015 dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr. 52, datë 03.12.2015. Kjo për arsye se ai ka zhvilluar studimet Master dhe ato dokorale në gjuhën angleze, dhe kryerja e studimeve të tilla të thelluara, konfirmon njohjen shumë të mirë të gjuhës në të cilën janë kryer studimet. Gjithashtu edhe kryerja e studimeve të drejtësisë në gjuhën greke pranë një universiteti grek, konfirmon njohjen shumë të mirë të kësaj gjuhe. Në Ligjin nr. 80/2015 dhe Udhëzimin e Ministrit të Arsimit nr. 52, datë 03.12.2015 nuk parashikohet konvertimi i mbrojtjes së gjuhës së huaj dhënë përpara Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të Universitetit të Tiranës (lidhur me mbrojtjen e gjuhës italiane), në nivele ndërkombëtare të njohjes së gjuhës së huaj (*kurdoherë kërkohet që mbrojtja të bëhet bazuar në testet ndërkombëtare*). Nga ana tjetër, Këshilli çmoi jo relevante thirrjen e ekspertit/përkthyes për të vlerësuar shkallën e zotërimit të kësaj gjuhe të huaj nga kandidati, në kushtet kur ai mbeti kandidati i vetëm në procedurën e përzgjedhjes për emërim, si dhe zotëronte me teste ndërkombëtare (diplomat e studimeve të thelluara) të gjuhës angleze dhe asaj greke. Megjithatë, në kushtet kur përmes certifikatave të lëshuara nga një institucion publik i profilizuar i arsimit të lartë vërtetohej që kandidati të ketë mbrojtur gjuhën e huaj si më lart (italisht) jo shumë vite më parë (konkretisht në vitin 2019), si dhe kur vërtetohej përdorimi nga ai, i kësaj gjuhe të huaj, duke mbajtur parasysh vlerësimin në momentin e mbrojtjes së gjuhës italiane dhe mungesën e një vlerësimi aktual, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin z. {...} me 1.5 pikë për njohuritë e tij në gjuhën angleze (provuar nga dokumentacioni si më sipër dhe bazuar në studimet e thelluara në gjuhën angleze), duke i shtuar 1 pikë tjetër për njohuritë në gjuhën italiane, gjuhën greke dhe atë gjermane (me certifikatë lëshuar nga një universitet i një shteti të OECD/BE).

17.4 Për rrjedhojë, për nënkriterin e vlerësimit “Aftësitë gjuhësore”, duke vlerësuar të gjitha të dhënat e administruara në harmoni me njëra-tjerën, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 2.5 pikë në total.

18. Përfundimisht, sa më sipër, për kriterin e vlerësimit “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 13 pikë në total.

19. Kriteri i dytë i Kategorisë “Meritat profesionale”, është “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”. Ky kriter vlerësimi ndahet në pesë nënkritere/indikatore/tregues, e më konkretisht:

- a) “Originaliteti dhe/ose impakti”;
- b) “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”;
- c) “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”;
- ç) “Interpretimi i harmonizuar”;
- d) “Referencat e praktikës gjyqësore”.

20. Neni 49, pika 6, shkronja “b”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019 dalë në zbatim të ligjit, përcaktojnë si kriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe vlerësimin e punës së kandidatit, përmes të paktën pesë dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës

së tij në profesion gjatë pesë viteve të fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi për këtë kriter bëhet përmes vlerësimit cilësor të pesë punimeve dhe dokumenteve profesionale gjatë pesë viteve të fundit të karrierës. Po ashtu, elemente shtesë mbi cilësinë e rezultateve profesionale mund të nxirren edhe nga dokumentet zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional të paraqitura nga kandidati ose të kërkuara nga ana e Këshillit prej autoriteteve përkatëse, si edhe dokumentet zyrtare që paraqesin cilësinë dhe arritjet gjatë eksperiencës në punë, nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky kriter, pra “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”, synon të identifikojë ata kandidatë të cilët kanë performuar në mënyrë të dalluar në fushën përkatëse të ushtrimit të profesionit, prandaj vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatëve bëhet duke u mbështetur në arritjen e rezultateve më të larta dhe të dallueshme profesionale, të konsideruara në përgjithësi, për të vlerësuar cilësinë e aftësive profesionale. Referuar Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, secilin nga pesë treguesit (“Origjinaliteti dhe/ose impakti”; “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”; “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”; “Interpretimi i harmonizuar”; “Referencat e praktikës gjyqësore”) vlerësohet dhe pikëzohet në maksimum me 5 pikë, e në total vlerësimi cilësor vlerësohet në maksimum me 25 pikë.

21. Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi që kandidati ka përgatitur dokumente profesionale dhe punime shkencore, të cilat janë të fokusuara në shumicën e rasteve në fushën e të drejtës civile.

22. Gjatë procedurës së përzgjedhjes u administruan pesë dokumente ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë pesë viteve të fundit, e më konkretisht:

a) Ankimi kundër vendimit nr. 24, datë 13.6.2018, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...};

b) Ankimi kundër vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...};

c) Ankim kundër vendimit nr. 58, datë 1.8.2018, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...};

ç) Ankimi kundër vendimit nr. 112, datë 4.3.2019, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...};

d) Ankimi kundër vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...};

23. Gjatë procedurës së përzgjedhjes u administruan edhe dokumente të tjerë ligjore të kandidatit,

- Ankim kundër vendimit nr. 273 datë 10.07.2020, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit znj. {...}{...};

- Ankim kundër vendimit nr. 221 datë 10.12.2019 të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit znj. {...}

- Ankim kundër vendimit nr. 229 datë 28.01.2020, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...};

- Ankim kundër vendimit nr. 269 datë 01.07.2020, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit znj. {...};

- Ankim kundër vendimit nr. 241 datë 26.02.2020, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit znj. {...};
- Ankim kundër vendimit nr. 249 datë 06.03.2020, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...};
- Ankim kundër vendimit nr. 86 datë 17.12.2018, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit znj. {...};
- Ankim kundër vendimit nr. 187 datë 24.7.2019, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...};
- Ankim kundër vendimit nr. 90 datë 20.12.2018, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...};
- Ankim kundër vendimit nr. 61 datë 02.08.2018, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...};
- Ankim kundër vendimit nr. 32 datë 05.07.2018, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit znj. {...};
- Ankim kundër vendimit nr. 42 datë 18.07.2018, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit znj. {...};

24. Gjatë procedurës së përzgjedhjes rezultoi që kandidati ka marrë pjesë dhe ka referuar në konferencat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si më poshtë:

1. “{...}” – (botuar në Book of Proceedings of the 5th International Conference on Humanities and Social Sciences - 2015);
2. “{...}. The diverse implications of the European Union instruments for economic and political reform. – (Faculty of Economics, University of Tirana & Faculty of Economics and Agribusiness, Agriculture University of Tirana in partnership ëith Regional Research Promotion Programme & University of Fribourg – 5-7 dhjetor 2013).
3. ‘{...}- (International Conference on Human and Social Sciences – Rome, Italy – 20-22 Shtator 2013).
4. “{...}– (International Conference on Human and Social Sciences - Rome, Italy – 20-22 Shtator 2013);
5. ‘{...}– (International Conference organized by the University of Peja ëith subject Effects of Global Risk in Transition Countries – 30 Qershor 2013).
6. “{...}– (International Conference organized by the University of Shkodra ëith subject Research and Education Challenges Toëards the Future. 23-25 Maj 2013).
7. “{...} (International Conference by the Laë University of Tirana ëith subject Celebrating 10 years of Ratification of the Rome Statute from the Republic of Albania. 25-26 Mars 2013)

8. “{...} (International Conference organized by the University Aleksandër Moisiu of Durrës and the University Luarasi ëith subject The State, Society and Laë. 15-16 Mars 2013)
9. ‘{...}’ (International Conference in Macedonia ëith subject: decentralization process in the Republic of Macedonia, key issues and the future developments. 25 Janar 2013)
10. ‘{...}. Albanian reality versus European’. (National Conference: Violence against children in Albania. 21 Nëntor 2012)
11. ‘{...}. (International Conference organized by the Ministry of Education of Albania ‘High Education in Albania’. 7-8 Dhjetor 2012)
12. “Corporate Albania – {...}. (International Conference at the European University of Tirana. 20 Nëntor 2011)
13. “{...}Integration’. (International Conference from the Europena University – AAB Kosovo in Tirana. 26-27 Tetor 2011)
14. “{...}. (National Conference at the European University of Tirana ‘Albanian justice in 100 years of independence. 17 Maj 2011).

25. Përveç sa sipër, gjatë procedurës së përzgjedhjes, kandidati u ftua të bëjë edhe një vetëvlerësim, kjo pasi, sa i përkiste vlerësimit të treguesit “Origjinaliteti dhe/ose impaktit”, nevojiteshin të dhëna konkrete të referuara nga kandidati, mbi të cilat Këshilli do të mund të identifikonte dhe të orientohej për origjinalitetin dhe/ose impaktin e pesë dokumenteve profesionale të përzgjedhur në kuadër të procesit të vlerësimit dhe pikëzimit. Gjithashtu, vetëvlerësimi, ndërsa duhej të fokusohet në treguesit e përcaktuar sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, do të shërbente edhe për një vlerësim të drejtë edhe për treguesit e tjerë të kriterit “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”.

26. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Origjinaliteti dhe/ose Impakti”:

26.1 Për indikatorin “Origjinaliteti dhe/ose Impakti”, pasi shqyrtoi përmbajtjen e dokumenteve si më lart, si dhe vetëvlerësimin e kandidatit, Këshilli vlerësoi se ato përbëjnë punë origjinale të autorit.

26.2 Në kuadër të vlerësimit të pesë dokumenteve ligjore mbi të cilat kandidati kërkoi që të vlerësohej (ankimeve të përpiluara nga ai gjatë funksionit si Komisioner Publik) evidentohet një paraqitje e re dhe origjinale e koncepteve juridike, evidentohet aftësia e kandidatit për të ndikuar në zhvillimin e praktikës gjyqësore, përmes krijimit të një jurisprudence në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apleimit, e cila kishte nevojë të saktësohej ose të sqarohet. Qasja e zhvilluar në ankimet e para të z. {...}, si Komisioner Publik, më vonë solli referimin e tij në ankimet e ngritura nga ana e Komisionerit Publik çka do përbente në vetvete një dokument me impakt të madh në vazhdimësinë e punës të Institucionit të Komisionerëve Publikë. Gjithashtu, përmes dokumenteve

të realizuara nga kandidati kontribuoi në elaborimin e doktrinës juridike, si dhe në interpretimin e ri të ligjit aty ku ekzistojnë paqartësi apo ka diskutime juridike lidhur me zbatimin e ligjit.

26.3 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Originaliteti dhe/ose Impakti”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin z. {...} me 5 pikë.

27. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”:

27.1 Për indikatorin “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”, Këshilli vlerësoi se në pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikundër edhe në publikimet shkencore dhe artikujt e tjerë profesional, kandidati shfaq aftësi shumë të mira të mbledhjes dhe analizës së informacionit dhe identifikon zgjidhje me anë të zhvillimit logjik të koncepteve ligjore.

27.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin z. {...} me 5 pikë.

28. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”:

28.1 Për indikatorin “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”, Këshilli vlerësoi se në pesë dokumentet profesionale të paraqitura nga kandidati, si edhe në botimet dhe artikujt e tjerë shkencorë, ai ka bërë paraprakisht një përcaktim të qartë të problemit, ka zhvilluar në mënyrë logjike konceptet juridike, ka përdorur në mënyrë korrekte dhe konsistente termat teknike. Po ashtu, kandidati ka përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe të drejtëpërdrejtë që mbërrin edhe tek publiku i gjerë, përveç se ai ka respektuar edhe rregullat gramatikore dhe të sintaksës. Gjithashtu, gjuha, paragrafët dhe struktura e fjalisë në këto dokumente, janë përzgjedhur nga kandidati në mënyrë të kujdesshme dhe i gjithë dokumenti ka vijueshmëri logjike.

28.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

29. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Interpretimi i harmonizuar”:

29.1 Për indikatorin “Interpretimi i harmonizuar”, Këshilli vlerësoi se në pesë dokumentet profesionale, si edhe në botimet dhe artikujt e tjerë shkencorë, kandidati identifikon dhe interpreton në mënyrë të harmonizuar burimet e ndryshme të së drejtës, si dhe tregon dhe argumenton ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e problemit. Në varësi të llojit të dokumentit, tematikës së trajtuar dhe qëllimit për të cilin është hartuar secili dokument, rezultoi se kandidati interpreton në përputhje me njëra-tjetrën parimet e së drejtës, burimet e së drejtës ndërkombëtare dhe asaj kombëtare, si dhe arsyeton zbatimin e ligjit në rastin konkret. Kjo është një cilësi shumë e rëndësishme për një gjyqtar të Gjykatës së Lartë, sidomos në kuadër të njësimin, ndryshimit apo të zhvillimit të

praktikës së Gjykatës së Lartë, ku nëpërmjet praktikës së saj gjyqësor ajo duhet të vendosë legjitimitet në lidhje me sigurinë juridike.

29.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Interpretimi i harmonizuar”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

30. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Referencat e praktikës gjyqësore”:

30.1 Për indikatorin “Referencat e praktikës gjyqësore”, Këshilli vlerësoi se në botimet, punimet dhe artikujt e tjerë shkencorë, si dhe referimeve të tij në konferenca shkencore, kandidati trajton dhe referon me efektivitet, në vendin e duhur e sipas llojit dhe qëllimit të aktit, praktikën e konsoliduar gjyqësore, praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë, praktikën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe praktikën e gjykatave ndërkombëtare etj.

30.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Referencat e praktikës gjyqësore”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

31. Përfundimisht, sa më sipër, për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 25 pikë në total.

32. Kriteri i tretë i Kategorisë “Meritat profesionale”, është “Kualifikimi Shtesë Profesional”. Ky kriter vlerësimi ndahet në katër nënkritere, e më konkretisht:

- a) “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike”;
- b) “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike”;
- c) “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit”;
- ç) “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”.

33. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike”:

33.1 Neni 49, pika 6, shkronja “a”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019 dalë në zbatim të ligjit, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe *ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë*. Ky përcaktim ligjor, vjen në përputhje me përcaktimet që ka bërë Ligji nr. 98/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 31, pika 1 dhe pika 3, që parashikojnë se: “1. Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ. ... 3. Kolegji Penal shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar për çështje penale, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj. Kolegji Penal gjykon në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Në rastet e gjykimeve, për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, Kolegji Penal gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. ...”.

33.2 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, në mënyrë ideale, Gjykata e Lartë përbëhet nga anëtarë me ekspertizë në fusha të ndryshme të së drejtës, me një veprimtari të njohur

profesionale. Fushat e ndryshme të ekspertizës plotësojnë njëra-tjetrën për të pasuruar dhe zgjeruar fushën e aktiviteteve të mbuluara nga Gjykata e Lartë. Për këtë arsye, ky kriter vlerësimi dhe pikëzimi i Kategorisë “Meritat profesionale”, synon të vlerësojë rëndësinë dhe dobinë e specializimit të arritur në përvojën e veçantë profesionale të kandidatit, në mënyrë që të sigurojë “plotësimin e ekspertizës” profesionale dhe të pasurojë kapacitetet profesionale të Gjykatës së Lartë me profesionistë të spikatur, ndër të tjerë, edhe nga fusha e të drejtës civile. Vlerësimi i kandidatëve referuar kohëzgjatjes së angazhimit të posaçëm ose të profilizuar në fushën konkrete të së drejtës, bëhet në mënyrë të përshkallëzuar, duke marrë parasysh edhe llojshmërinë e angazhimit në fushën specifike, si lektor i së drejtës, avokat, etj. Ky nënkriter vlerësohet deri në 6 pikë në rastin kur kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike është mbi 15 vjet.

33.3 Kandidati z. {...} ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile e për pasojë, kohëzgjatja e angazhimit të tij në fushën specifike vlerësohet pikërisht në këtë fushë të së drejtës.

33.4 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit, ka një përvojë të gjatë profesionale në fushën e të drejtës civile, përmbi 15 vjet. Konkretisht: si avokat - 10 vjet pedagog në Shqipëri, 3 vjet e 9 muaj asistent profesor në Universitetin Kombëtar të Athinës si dhe 2 vjet Jurist. Në total, kandidati ka përvojë profesionale me kohë të plotë si avokat, si lektor i të drejtës dhe si jurist i nivelit të lartë në administratën publike përmbi 15 vjet (për më tepër shiko Vendimin nr. 560, datë 13.11.2020).

33.5 Megjithatë, duhet thënë se veprimtaria profesionale e kandidatit nuk ka qenë një punë e zakonshme e përditshme, por ka qenë një angazhim tërësisht ndaj të drejtës dhe asaj institucionale. Z. {...} ka treguar një zell, përtej angazhimit të zakonshëm, duke u përpjekur që vetë të thellojë njohuritë në fushat e të drejtës civile, duke bërë specializimet përkatëse si dhe studime pasuniversitare.

33.6 Ndaj nga sa më lart, për nënkriterin e vlerësimit “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike”, pasur parasysh kohëzgjatjen e angazhimit në fushën specifike (të së drejtës civile), si dhe shumëllojshmërinë e angazhimeve në këtë fushë, Këshilli çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 6 pikë.

34. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike”:

34.1 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli cakton deri në 2 pikë për botime relevante në fushën specifike, të tilla si monografi, artikuj në revista shkencore, raporte, udhëzues, komentare etj. Këshilli merr parasysh numrin e botimeve si edhe ndikimin e rezultateve profesionale në atë fushë, si për shembull përdorimin si pjesë e programeve të studimit, në praktikën e institucioneve, si referencë në punimet e autorëve të tjerë. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë nëse botimet relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale të kandidatit në fushën specifike janë realizuar në vendet e BE/OECD. Gjithashtu, Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë për impaktin e botimeve relevante të kandidatit në zhvillimin e doktrinës dhe të jurisprudencës gjyqësore në këtë fushë.

34.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi që kandidati z. {...} ka punuar disa botime në fushat e së drejtës, e për këtë u administruan:

(artikuj shkencorë në fushën e së drejtës, të botuar në revista shkencore dhe profesionale)

1. “{...}”;
2. “{...}” - (botuar në Balkan Journal of Interdisciplinary Research. Maj 2019);
3. “{...}” – (botuar nga International Labour Organization. Dhjetor 2017);
4. “{...}” - (botuar në Albanian Review of Law of Luarasi University. Qershor 2015);
5. “{...}” – (botuar në Hellenic Review of European Law. 2015);
6. “{...} – Legal Innovations to the Strasbourg Court and the Decision Qama versus Albania” – (botuar në Mediterranean Journal of Social Sciences. 2013);
7. “{...}” – (botuar në Academic Journal of Interdisciplinary Studies. 2013);
8. “{...}” – (botuar në IUS & JUSTICIA Legal review of the European University of Tirana. 2010 dhe 2011);
9. “{...} – (Botuar Foundation of Economic Freedom. 2010);
10. “{...}, – (botuar në Greek legal journal ‘Public Law Applications’. 2009);
11. “{...}” – (botuar në Internet Site of Constitutional Law of Dr. Andreas Dimitropoulos Professor at the university of Athens/Public Law Department with publications containing constitutional legal articles – 2007-2008);

34.3 Nga dokumentet e administruara, me rëndësi në këtë pikë është fakti që botimet e tij kanë ndikuar në edukimin e studentëve të drejtësisë. Gjithashtu rezultoi se kandidati ka marrë pjesë në draftimin dhe përgatitjen e Komentarit të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë sipas direktivave të Bashkimit Evropian (Commentary of the Albanian Labour Code under EU directives) një punim mjaft i rëndësishëm për studentët e së drejtës si dhe për procesin e hapjes dhe zhvillimit të negociatave për anëtarësimin në BE.

34.4 Ndaj nga sa më lart, për nënkriterin e vlerësimit “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike”, duke patur parasysh numrin e botimeve të kandidatit, por që kryesisht janë në fushën publike, si dhe ndikimin e tyre në Shqipëri e më gjerë, Këshilli çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 3 pikë.

35. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislativacionit”:

35.1 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli cakton deri në 4 pikë për konsulentat në fushën përkatëse të së drejtës si edhe për kontributet në hartimin e legjislativacionit, bazuar në të dhëna të dokumentuara. Këshilli vlerëson rolin, sasinë dhe cilësinë e angazhimit, dhe ndikimin në veprimtarinë specifike. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë për shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit duke vlerësuar nëse konsulenca në fushën përkatëse të ligjit është realizuar në vendet e BE/OECD.

35.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka dhënë kontribut në hartimin e legjislacionit. Konkretisht ai është bashkëautor i një Komentari i draftit të kodit të punës i cili është një punim që ndikon në legjislacionin e kodit të punës. Ky komentari është hartuar nga katër ekspertë të fushës pas një kontrate me ILO në Gjenevë, institucion i cili në momentin e draftit të hartuar nga shteti shqiptar kërkonte një komentari të tijin për të kontribuar në legjislacionin e të drejtës së punës. Konkretisht, për këtë nënkriter vlerësimi dhe pikëzimi, gjatë procedurës së përzgjedhjes për emërim u administruar këto dokumente si vijon: “{...}. Publication from ILO-Geneve, December 2015”.

35.3 Ndaj nga sa më lart, për nënkriterin e vlerësimit “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 3 pikë.

36. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”:

36.1 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit ky nënkriter është zbërthyer në tre tregues, e konkretisht:

- i) “Pjesëmarrje në konferenca shkencore”;
- ii) “Mësimdhënie”
- iii) “Çmime dhe tituj”.

36.2 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli vlerëson në veçanti edhe referimet në konferenca shkencore kombëtare, në fushën specifike të specializimit, bazuar në fjalimet e dorëzuara, dhe cakton deri në 2 pikë, duke marrë parasysh numrin e referimeve dhe rolin e referuesit. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë nëse referimet në fushën specifike - të dokumentuara nga fjalimet e dorëzuara nga kandidati - janë realizuar në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE/OECD, duke marrë parasysh numrin e referimeve dhe rolin e referuesit. Këshilli vlerëson edhe përvojën e mësimdhënies, në fushën specifike të specializimit, për profesionistët (për shembull gjyqtarët, prokurorët, avokatët etj.), dhe duke marrë parasysh numrin e angazhimeve, kohëzgjatjen, institucionin, rolin si mësimdhënës/trajnes, cakton deri në 4 pikë. Për përvojën si pedagog, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme ose si "profesor vizitor/personel akademik i ftuar", në fushën specifike të specializimit, në vendet e BE/OECD, Këshilli cakton deri në 2 pikë. Kandidatit i caktohen gjithashtu deri në 2 pikë për çmime ose tituj të veçantë nderi në vendet e BE/OECD.

36.3 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Pjesëmarrje në konferenca shkencore”:

36.3.1 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka një sërë pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, provuar këto me referimet përkatëse, ku për këtë u administruan:

1. “{...}” – (botuar në Book of Proceedings of the 5th International Conference on Humanities and Social Sciences - 2015);
2. “{...}” – (Faculty of Economics, University of Tirana & Faculty of Economics and Agribusiness, Agriculture University of Tirana in partnership ëith Regional Research Promotion Programme & University of Fribourg – 5-7 dhjetor 2013).

3. ‘{...}- (International Conference on Human and Social Sciences – Rome, Italy – 20-22 Shtator 2013).
4. “{...}– (International Conference on Human and Social Sciences - Rome, Italy – 20-22 Shtator 2013);
5. ‘{...}– 30 Qershor 2013).
6. “{...}– (International Conference organized by the University of Shkodra ëith subject Research and Education Challenges Toëards the Future. 23-25 Maj 2013).
7. “{...}’ (International Conference by the Laë University of Tirana ëith subject Celebrating 10 years of Ratification of the Rome Statute from the Republic of Albania. 25-26 Mars 2013)
8. “{...} (International Conference organized by the University Aleksandër Moisiu of Durrës and the University Luarasi ëith subject The State, Society and Laë. 15-16 Mars 2013)
9. ‘IPA funds for Albania’ (International Conference in Macedonia ëith subject: {...} 25 Janar 2013)
10. ‘{...}’. (National Conference: Violence against children in Albania. 21 Nëntor 2012)
11. ‘{...}. (International Conference organized by the Ministry of Education of Albania ‘High Education in Albania’. 7-8 Dhjetor 2012)
12. “.{...}. (International Conference at the European University of Tirana. 20 Nëntor 2011)
13. {...}Tirana. 26-27 Tetor 2011)
14. “{...}. 17 Maj 2011).

36.3.2 Sipas dokumenteve të administruara, rezultoi që kandidati z. {...} të ketë një sërë pjesëmarrjesh në konferenca shkencore. Pjesëmarrjet e tij në konferenca shkencore janë finalizuar edhe me botimin e referimeve në revistat juridike të ndryshme. Pavarësisht se konferenca ndërkombëtare në shumicën e rasteve është zhvilluar në Shqipëri dhe jo në ndonjë vend të BE/OECD (por në disa raste universitetet organizuese janë të vendeve të BE/OECD), ajo është konferencë ndërkombëtare pasi në përcaktimin e një konference shkencore ndërkombëtare nuk ka rëndësi vendi se ku ajo zhvillon punimet por mënyra e organizimit të saj, angazhimi i universiteteve të huaja, shtetësia e anëtarëve të bordit të konferencës që miraton shkrimet.

36.3.3 Ndaj nga sa më lart, për treguesin “Pjesëmarrje në konferenca shkencore”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 4 pikë.

36.4 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Mësimdhënie”:

36.4.1 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati ka kryer veprimtarinë e mësimdhënies, kryesisht në fushën specifike për pozicionin e lirë, atë të së drejtës civile, por edhe në fusha të tjera, si e drejtë tregtare, e drejtë detyrimesh etj. Konkretisht ai ka një përvojë mbi 10 vjeçare si pedagog i së drejtës në Shqipëri/ Kosovë/ ASPA etj.

- Gjithashtu bazuar edhe në dokumentacionin e dorëzuar vihet re që studimet Post-Doktorale janë kryer në shtetin e Zvicres (OECD) ku kandidati ka qenë edhe i ftuar si “Guest Professor”.
- Gjithashtu edhe gjatë studimeve doktorale që janë kryer në shtetin e Greqisë ai ka pasur edhe një përvojë disa vjeçare si pedagog (asistent profesor) në një vend të OECD, konkretisht në Universitetin Kombëtar të Athinës/Fakulteti i Drejtësisë.
- Gjithashtu kandidati ka mbajtur pozicionin e Shefit të Departamentit të ligjit dhe Drejtor i Programeve Master në Universitetin e Neë Yorkut, Tiranë ku ka qenë edhe profesor i lëndëve e drejtë tregtare, e drejtë civile, e drejtë e krahasuar civile.
- Në Universitetin Luarasi ka mbajtur pozicionin e Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë si dhe ka kryer veprimtarinë e mësimdhënies në lëndët e drejtë Kushtetuese, e drejtë administrative si dhe metoda kërkimi në shkencat juridike.
- Në Universitetin Europian të Tiranës ka kryer veprimtarinë e mësimdhënies në lëndët e drejtë civile, metoda kërkimi si dhe shkrim dhe arsyetim ligjor.
- Në Universitetin Kombëtar të Athinës ka kryer veprimtarinë e mësimdhënies si asistent pedagog në lëndët e drejtë kushtetuese dhe të drejtat kushtetuese në nivelin Bachelor dhe Master.

36.4.2 Sipas dokumenteve të administruara, kandidati z. {...} ka përvojë të gjatë në mësimdhënie, si për studentët e së drejtës, ashtu edhe për profesionistët, pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Nga dokumentacioni i administruar për kandidatin rezultoi se ai ka qenë i ftuar si Guest professor ose si “profesor vizitor/personel akademik i ftuar” në një nga vendet e BE/OECD, në shtetin e Zvicrës.

36.4.3 Ndaj nga sa më lart, për treguesin “Mësimdhënie”, duke patur parasysh kohëzgjatjen, institucionin, rolin si mësimdhënës/trajnuës të kandidatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se ai duhet të vlerësohet me 6 pikë.

36.5 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Çmime dhe tituj”:

36.5.1 Nga dokumentacioni i administruar për kandidatin, nuk rezultoi që ai të ketë çmime ose tituj të veçantë nderi në vendet e BE/OECD.

36.5.2 Ndaj nga sa më lart, për treguesin “Çmime dhe tituj”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 0 pikë.

36.6 Për rrjedhojë, për nënkriterin e vlerësimit “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 10 pikë në total.

37. Përfundimisht, sa më sipër, për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi shtesë profesional”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 22 pikë në total.

38. Kategoria e dytë e vlerësimit është “Meritat morale dhe etike”. Kjo kategori vlerësimi ndahet në tre kritere, e më konkretisht:

- 1) “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”;
- 2) “Nderi dhe dinjiteti”;
- 3) “Reputacioni”.

39. Neni 136, pika 3, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton se: “3. *Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë për zgjidhet mes juristëve të spikatur...*”. Nga interpretimi i dispozitave kushtetuese, por dhe i atyre të ligjit të posaçëm, lex specialis, rezulton se ligji material ka përçarur qëllimin e Kushtetutbërësit për transformimin e Gjykatës së Lartë “në një gjykatë karriere” përmes vendosjes së kritereve transparente për emërimin e gjyqtarëve nga të dy kategoritë (gjyqtarë dhe jogjyqtarë/juristë të spikatur)”, për të garantuar një përbërje cilësore jo vetëm nga pikëpamja profesionale, por mbi të gjitha edhe të integritetit të figurës. Për pasojë, përmes kuadrit rregullator në tërësi, nëpërmjet kritereve të vendosura, është synuar identifikimi i juristëve të aftë profesionalisht dhe me integritet të lartë moral, pasi në suksesin e vërtetë të një Gjykate të Lartë ndikojnë sa dijet ligjore të gjyqtarëve, aftësia e tyre për të ushtruar që në fillim disiplinë doktrinare, por po aq të rëndësishme janë edhe cilësitë dhe integriteti i tyre, në mënyrë që të kontribuojnë në pavarësinë e gjykatës, për ta bërë atë të pathyeshme ndaj çdo lloj sulmi apo fenomeni negativ që e cënojnë atë.

40. Sipas Vendimit 102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kategori bazohet në atë nëse kandidati miraton, respekton dhe mbështet vlerat themelore të punës së pritshme të gjyqtarit, siç janë (1) shmangia e shfaqjes së pahijshme, (2) nderi dhe dinjiteti, dhe (3) reputacioni, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë. Kandidati duhet të jetë i vetëdijshëm se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut. Vlerësimi dhe pikëzimi i kësaj kategorie vlerësimi, sipas kritereve më sipër, bëhet sipas një rendi zbritës, duke supozuar se kandidati ka integritet etik dhe moral të plotë. Mbi këtë qasje, kandidati e fillon procedurën e vlerësimit me totalin e pikëve referuar secilit kriter të kësaj kategorie vlerësimi, dhe nëse burime të provuara dhe të besueshme evidentojnë një mangësi në lidhje me integritetin moral dhe etik, Këshilli cakton për kandidatin minimumin e pikëve (1 pikë). Të dhënat për vlerësim dhe pikëzim të kandidatit janë ato që rezultojnë nga gjetjet në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit apo nga informacione të tjera të verifikuara nga Këshilli.

41. Për kandidatin z. {...}, gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, nuk rezultoi asnjë gjetje negative në raport me figurën, referuar treguesve respektivë për secilin kriter të kësaj kategorie vlerësimi. Po ashtu, për kandidatin, gjatë gjithë procesit të kandidimit nuk rezultoi ndonjë informacion tjetër negativ në lidhje me figurën, referuar treguesve respektivë për secilin kriter të kësaj kategorie vlerësimi.

42. Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} të jetë person që gëzon integritet dhe moral të plotë, ku për këtë u administruan:

- Vlerësimin e Rektorit të “Universiteti European i Tiranës”, Prof. Dr. {...}, që mban datën 09.12.2020 – të dhënat janë referuar më lart;
- Vlerësimin e ish-Rektorit të “Universiteti Luarasi”, Prof. Dr. {...}, që mban datën 07.12.2020 - të dhënat janë referuar më lart;
- Vlerësimin e Dekanit të “Canadian University”, Prof. Assoc {...}, që mban datën 07.12.2020 - të dhënat janë referuar më lart;
- Vlerësimin e ish-Rektorit të “Universitetit të Nju Jorkut”, Prof. {...}, që mban datën 07.12.2020 - të dhënat janë referuar më lart;
- Të dhëna nga intervistimi i kandidatit, më datë 25.03.2022.

43. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”:

43.1 Sipas dokumentacionit të administruar, nisur nga të dhënat që rezultuan nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim si anëtar për në Gjykatën e Lartë, intervista me kandidatin, komunikimi i tij gjatë gjithë procedurës së përzgjedhjes, si dhe referuar dokumenteve të tjerë, përfshirë ato të aksesueshme publikisht, si dhe në mungesë të ndonjë të dhënë të ardhur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor gjatë kohës që procedura e përzgjedhjes ishte bërë publike edhe nëpërmjet medias, për kriterin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”, nuk rezulton që kandidati të ketë treguar mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive. Po ashtu, nuk rezultoi që kandidati: të ketë tejkalime dhe ekstravagancë në ushtrimin e profesionit; të ushtroj apo të ketë ushtruar në të kaluarën profesionin me njëanshmëri; të ketë kërkuar nëpërmjet ndërhyrjes, që të përfitojë një avantazh të pamërituar për veten ose për të tjerët: të ketë pranuar dhurata ose avantazhe për veten ose për të afërmit, kur ushtron detyrën ose profesionin. Gjithashtu, edhe gjatë intervistës së zhvilluar, kandidati tregoi një sjellje dhe komunikim etik, duke treguar respekt dhe vetëpërmbytje.

43.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 5 pikë.

44. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Nderi dhe dinjteti”:

44.1 Sipas dokumentacionit të administruar, si dhe referuar çdo të dhënë tjetër që ka rezultuar për indikatorët si më sipër, në lidhje me kriterin “Nderi dhe dinjteti”, rezultoi që kandidati transmeton vlera personale dhe profesionale, ndërkohë që nuk rezultoi nga burimet e vlerësimit dhe as nga ndonjë e dhënë tjetër, që kandidati të ketë sjellje të tilla që i kundërshtojnë këto të dhëna. Nuk rezultoi ndonjë e dhënë sipas të cilës kandidati: të karakterizohet nga mungesa e vëmendjes dhe interesimit për respektimin dhe dinjtetin e individëve; shpërdoron fondet publike, keqpërdor kohën e punës, personelin dhe burimet për qëllime private; të shfaqë sjellje të bullizmit, frekuentim të dobët në punë apo përdorim të substancave të ndaluara. Përkundrazi, referuar dokumentacionit të administruar, opinioneve vlerësuese të drejtuesve të institucioneve, subjekteve si më lart, ku kandidati ka marrë pjesë, ai reflekton vlera personale dhe profesionale, është një shembull për kolegët e tij si dhe për studentët, ndërkohë që opionet e dhëna vënë theksin të integriteti i tij, të sjellurit me nder dhe dinjtet.

44.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Nderi dhe dinjiteti”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 5 pikë.

45. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Reputacioni”:

45.1 Sipas dokumentacionit të administruar, si dhe referuar çdo të dhënë tjetër që ka rezultuar nga indikatorët si më sipër, në lidhje me kriterin “Reputacioni”, rezultoi që kandidati shfaq arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojës në punë, ndërkohë që nuk rezultoi nga burimet e vlerësimit dhe as nga ndonjë e dhënë tjetër, që kandidati të ketë shfaqur sjellje të tilla që nuk përmbushin pritshmëritë e qytetarëve dhe të shoqërisë në lidhje me cilësitë profesionale të gjyqtarit, të tilla si: rezerva dhe diskrecioni, kujdesi dhe respekti, si dhe cilësitë personale si: mençuria, besnikëria, humanizmi, serioziteti dhe matura. Gjithashtu, Këshilli konsideroi përgjigjen e dhënë nga kandidati në pyetjen e parashtruar nga njëri prej anëtarëve të Këshillit, se cila kishte qenë dilema etike më e madhe me të cilën ai është ndeshur dhe se si e kishte zgjidhur atë. Kandidati parashtroi situata, ku ai kishte pasur dilema apo sfida gjatë punës së tij si Komisioner Publik, dhe zgjedhjet që ai kishte bërë ishin të një niveli të lartë etik dhe moral. Vendimmarrja e tij si Komisioner Publik, lidhur me ankimin e subjekteve të rivlerësimit, solli një frymë të re të mosndikimit nga faktorë të jashtëm.

45.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Reputacioni”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 5 pikë.

46. Kategoria e tretë e vlerësimit është “Meritat organizative dhe menaxheriale”. Kjo kategori vlerësimi ndahet në katër kritere, e më konkretisht:

- 1) “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur”;
- 2) “Aftësitë vendimmarrëse”;
- 3) “Aftësitë e komunikimit”;
- 4) “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore”.

47. Referuar nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në lidhje me emërimet në Gjykatën e Lartë, ndër të tjera, përcaktohet se: “...*Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur...*”. Sipas Vendimit 102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kategori mban parasysh se gjyqtari duhet të ketë aftësi të mira organizative dhe menaxheriale në mënyrë që të jetë produktiv. Në këtë kuptim, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht punën. Produktiviteti, në çdo profesion dhe detyrë, është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë kandidati përdor kohën e tij, si kur punon vetëm ashtu edhe në grup me të tjerë.

48. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur”:

48.1 Referuar jetëshkrimit, dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, si dhe të dhënave që rezultuan nga intervista me kandidatin, rezultoi se kandidati z. {...} ka një platformë dhe vizion të qartë në lidhje me objektivat nëse zgjidhet anëtar i Gjykatës së Lartë dhe për këtë u administruan:

- Dokumenti përshkrues mbi motivet dhe objektivat nëse emërohet gjyqtar në Gjykatën e Lartë;
- Të dhëna nga intervistimi i kandidatit, më datë 25.03.2022

48.2 Sipas dokumentit të administruar “Dokumentit përshkrues mbi motivet dhe objektivat nëse emërohet gjyqtar në Gjykatën e Lartë” si dhe intervistës së zhvilluar, Këshilli vlerësoi cilësinë, vlerën dhe origjinalitetin e arsytimit dhe objektive të prezantuara nga kandidati, ku ai shpalosi programin dhe vizionin e tij mbi qasjen për të realizuar një organizim dhe funksionim cilësor dhe efikas të Gjykatës së Lartë. Këshilli vlerësoi motivet dhe arsytet që e kanë shtyrë kandidatin për të kandiduar për në pozicionin vakant pranë Gjykatës së Lartë, që janë pikërisht karriera dhe angazhimi i tij i gjatë, si pedagog, avokat, etj. të fokusura në veçanti në fushën e të drejtës civile, por edhe institucionale, të cilat rritin kuptueshmërinë dhe përkushtimin e tij në lidhje me vetë rolin që ka gjyqtari i Gjykatës së Lartë. Referuar “Dokumentit përshkrues mbi motivet dhe objektivat nëse emërohet gjyqtar në Gjykatën e Lartë”, si dhe intervistës së dhënë përpara Këshillit me datë 25.03.2022, kandidati i ka synimet e qarta nëse zgjidhet anëtar i Gjykatës së Lartë e më konkretisht, të ofrojë modelin e një gjyqtari të drejtë profesionist, të kontribuojë duke ofruar modelin e një gjyqtari të ndërgjegjshëm, duke aplikuar standardet më të larta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare dhe ligjet e brendshme, të kontribuojë për rikthimin dhe forcimin e besimit të publikut ndaj Gjykatës së Lartë përmes vendimeve gjyqësore të drejta dhe profesionale, të rrisë besimin e publikut ndaj Gjykatës së Lartë duke garantuar një proces të rregullt ligjor, si dhe në respektim të parimit të sigurisë juridike përmes vendimeve gjyqësore të njehsimit të praktikës gjyqësore apo zhvillimit të saj, të ofrojë modelin e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë të pavarur në vendimmarrje dhe të respektojë sjelljen dhe etikën profesionale jo vetëm gjatë detyrës dhe në ambientet e gjykatës, por edhe jashtë saj, duke dhënë garanci për vlera të larta morale në shoqëri. Kandidati vuri theksin disa herë në faktin që Gjykata e Lartë duhet të krijojë një praktikë, ose ndryshe doktrinë e cila mund të realizohet edhe me kontributin e tij, duke patur parasysh formimin e tij profesional. Gjithashtu ai nënvizoi rolin e shërbimit ligjor pranë kësaj gjykate, duke theksuar se kjo njësi dhe mirëfunksionimi i saj janë elementët kyç për një gjykim sa më të shpejtë e të drejtë.

48.3 Nga sa rezultoi, Këshilli vlerësoi: kuptimin e thellë që kandidati ka për rolin e tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, sikundër edhe për rolin e kësaj gjykate; vizionin e kandidatit në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballlet Gjykata e Lartë, si nga perspektiva organizative, ashtu edhe e çështjeve thelbësore të së drejtës, si dhe mendimet dhe sugjerimet konkrete të kandidatit për t'i adresuar këto sfida.

48.4 Ndaj nga sa më lart, për kriterin e vlerësimit “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

49. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë vendimmarrëse”:

49.1 Referuar jetëshkrimin, dokumentacionin të administruar gjatë procedurës, si dhe të dhënave që rezultuan nga intervista me kandidatin, rezultoi se kandidati z. {...} ka aftësi të fituara në përvojën, pozicionet dhe përgjegjësitë e mbuluara, në lidhje me aspektet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin dhe administrimin e punës dhe për këtë u administrua dokumentacioni që ka të bëjë me eksperiencën e punës së tij, si pedagog, ekspert për çështje të së drejtës civile, Komisioner Publik, përfshirë edhe përgjegjësitë që ai ka mbuluar në këto pozicione, ku rezulton se ai paraqet aftësi shumë të mira menaxhuese, planifikuese dhe në administrimin e punës.

49.2 Sipas dokumenteve të administruara, rezultoi se kandidati {...} ka pasur pozicione të ndryshme pune si pedagog, ekspert për çështje të së drejtës civile, dhe së fundmi si Komisioner

Publik. Duke pasur në konsideratë edhe përgjegjësitë që ai ka mbuluar në këto pozicione të ndryshme dhe të rëndësishme edhe në jetën publike, Këshilli vlerësoi se kandidati paraqet aftësi shumë të mira menaxhuese, planifikuese dhe në administrimin e punës. Këshilli në këtë pikë, mbajti në konsideratë edhe faktin se kandidati ka mbajtur dhe mban pozicione drejtuese, ku aftësitë vendimarrëse shpalosen më shumë. Gjithashtu, gjatë intervistës, kandidati tregoi vendosmëri në lidhje me çështje të ndryshme që kishin nevojë për zgjidhje për funksionimin sipas ligjit të Gjykatës së Lartë, duke theksuar nismat dhe vendimmarrjet që duhet të merreshin për zgjidhjen e problematikave kryesore aktualisht në Gjykatën e Lartë, në kuadër të organizimit dhe përmirësimit të burimeve njerëzore dhe stafit ndihmës të ndihmësve dhe këshilltarëve ligjor, si dhe shndërrimin e saj në një Gjykatë që “zhvillon praktikën gjyqësore”, duke dhënë vendime njësuere të arsyetuara dhe bindëse, cilësi këto që vendosin një siguri në rendin juridik dhe shkurtojnë procedurat e gjykimeve.

49.3 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Aftësitë vendimarrëse”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 4 pikë.

50. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë e komunikimit”:

50.1 Referuar jetëshkrimit, dokumentacionit të administruar gjatë procedurës të cilat shërbyen edhe për vlerësimin e kriterit “Aftësitë vendimarrëse”, si dhe të dhënave që rezultuan nga intervista me kandidatin, rezultoi se kandidati z. {...} ka aftësi shumë të mira për t’u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize. Rezultoi që kandidati të ketë punuar në pozicione të ndryshme pune, të cilat kanë qenë dhe sfiduese lidhur me peshën dhe ndjeshmërinë që kanë përçar tek publiku, ku dhe është evidentuar për aftësitë e tij të mira komunikuese. Gjithashtu, aftësitë e tij të komunikimit u shpalosën qartë edhe në seancën dëgjimore përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku kandidati u përgjigj në mënyrë të qartë dhe koncize në lidhje me pyetjet e parashtruara nga anëtarët. Ai komunikoi me etikë, në mënyrë të matur dhe me respekt. Kandidati kuptoi drejt pyetjet e bëra nga anëtarët e Këshillit dhe iu përmbajt kontekstit në të cilën u parashtruan pyetjet e bëra. Ai reflekton vendosmëri dhe vetëbesimin në sipërmarrjen që ka marrë përsipër, duke folur me efektivitet me qëllim që të kuptohet nga të tjerët dhe personave që iu drejtohet, cilësi kjo shumë e rëndësishme për mënyrën sesi funksionon dhe vetë Gjykata e Lartë.

50.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Aftësitë e komunikimi”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

51. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore”:

51.1 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka vijueshmëri në punë të zhvilluara në ekip dhe punë në ambiente multidisiplinore dhe në lidhje me këtë kriter, Këshilli vlerësoi kandidatin bazuar në të njëjtin dokumentacion që vlerësoi edhe për kriteret “Aftësitë vendimarrëse” dhe “Aftësitë e komunikimit”, si dhe të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar në lidhje me punën në ekip dhe në ambiente multidisiplinore të kandidatit. Duke vlerësuar se ai ka punuar shpesh në ambiente multidisiplinore dhe punë në grup, referuar edhe vlerësimeve të përcjella nga drejtuesit e institucione përkatëse që kanë vlerësuar punën, kompetencat dhe aftësitë e kandidatit për të punuar në grup, Këshilli çmoi se kandidati është i përshtatshëm për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, pasi reflekton kompetenca dhe aftësi për të punuar në kolegje me gjyqtarë të tjerë, për të

shkëmbyer lirshëm dhe në mënyrë efektive pikëpamjet me kolegët dhe disponueshmërinë për të negociuar mospërputhjen e pikëpamjeve, nëse këto shfaqen. Sipas Këshillit, bazuar edhe në përgjigjet e dhëna gjatë intervistës, kandidati demonstron një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësi për të qenë pjesë e një komuniteti pune, pra aftësinë për të punuar në ekipe me kolegët dhe anëtarët e stafit.

51.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore”, duke vlerësuar eksperiencën e kandidatit gjatë karrierës, në punën në ekip dhe në ambiente multidisiplinore, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

52. Sa më lart, në përfundim të arsyetimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për secilën kategori, kriter, nëkriter dhe tregues, Këshilli i Lartë Gjyqësor e vlerësoi kandidatin {...} në total me 85 (tetëdhjetë e pesë) pikë.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikat 1-6, Seksioni D, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”,

VENDOSI:

1. Vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit z. {...}, si më poshtë:

A. Kategoria “Meritat profesionale”:

1. Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”:

- a) Nënkriteri “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi” - 1 pikë;
- b) Nënkriteri “Rezultatet e programeve të formimit fillestar” - 0 pikë;
- c) Nënkriteri “Rezultatet e përvojës në profesion” - 4 pikë;
- ç) Nënkriteri “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”:
 - i) Treguesi “Rezultatet e trajnimeve të tjera” - 0 pikë;
 - ii) Treguesi “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare” - 1,5 pikë;
 - iii) Treguesi “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë” - 4 pikë;
- d) Nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” - 2,5 pikë;

2. Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”:

- a) Indikator “Origjinaliteti dhe/ose impakti” - 5 pikë;

- c) Indikatori “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” - 5 pikë;
 - c) Indikatori “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” - 5 pikë;
 - ç) Indikatori “Interpretimi i harmonizuar” - 5 pikë;
 - d) Indikatori “Referencat e praktikës gjyqësore” - 5 pikë;
3. Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional”:
- a) Nënkriteri “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” - 6 pikë;
 - b) Nënkriteri “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” - 3 pikë;
 - c) Nënkriteri “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” - 3 pikë;
 - ç) Nënkriteri “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”:
 - i) Treguesi “Pjesëmarrja në konferenca shkencore” - 4 pikë;
 - ii) Treguesi “Mësimdhënie” - 6 pikë;
 - ii) Treguesi “Çmime dhe tituj” - 0 pikë;
- B. Kategoria “Meritat morale dhe etike”:
- 1. Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” - 5 pikë;
 - 2. Kriteri “Nderi dhe dinjiteti” - 5 pikë;
 - 3. Kriteri “Reputacioni” - 5 pikë;
- C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”:
- 1. Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” - 2 pikë;
 - 2. Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” - 4 pikë;
 - 3. Kriteri “Aftësitë e komunikimit” - 2 pikë;
 - 4. Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” - 2 pikë;
- Totali 85 pikë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR